

Ministria e Financave në bazë të nenit 22 paragrafi (1) alineja 2, paragrafi (3), paragrafi (8) të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 143/19, 14/20 dhe 208/24), nenit 22 paragrafi (1) pika 1, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 110/19, 267/20, 151/21, 288/21, 111/23, 39/25, 74/25 dhe 124/25), si dhe Rregullores së sistematizimit të vendeve të punës në Ministrinë e Financave, publikon

SHPALLJE NUMËR 2/2026 PËR PUNËSIM NË MINISTRINË E FINANCEVE

Ministria e Financave publikon shpallje për punësimin e 1 personi me kohë të caktuar, për shkak të rritjes së vëllimit të përkohshëm të punës për periudhë prej një viti, respektivisht në këtë vend të punës:

1. Shofer, Njësia e Mbështetjes Administrative dhe Teknike, Sektori i Çështjeve të Përgjithshme – (1 realizues);

Kualifikimet e nevojshme:

- arsim i mesëm;
- provim për patentë shoferi të kategorisë B
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Orari i punës:

- orari ditor i punës me fillim nga ora 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i orarit ditor nga ora 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premten;

Paga themelore neto: 26.352,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dëshmi për përmbushjen e kushteve që kërkohen për vendin e caktuar të punës për të cilin aplikojnë, përkatësisht: biografi e shkurtër – CV me telefonin e kontaktit dhe adresën; fotokopje e dëshmisë për arsimin e kryer që kërkohet për vendin e caktuar të punës; fotokopje e certifikatës së shtetësisë si dhe fotokopje e patentës së shoferit të kategorisë B.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në këtë adresë:

**Ministria e Financave
rr. “Dame Gruev” nr. 12, 1000 Shkup
(me shënim “për shpallje punësimi”)**



Në zarf duhet të shënohet numri i shpalljes për të cilin aplikohet, me shënimin: “Mos e hap”.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është tri (3) ditë pune, duke e llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetata ditore.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni me vonesë, i paplotësuar dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Pas shqyrtimit të fletëparaqitjeve të dorëzuara, kandidatët të cilët kanë dokumentacion të rregullt do të thirren për selektim shtesë në hapësirat e Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave do ta kryejë përzgjedhjen në afatin e përcaktuar sipas nenit 23 paragrafi (2) të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

Personat kontaktues:

Lilijana Stojanovska - tel. 02/ 3255 624; lilijana.stojanovska@finance.gov.mk

Kimet Kurtishi - tel. 02/ 3255 634; kimet.kurtisi@finance.gov.mk